



REPUBLIKA E KOSOVËS
Komuna e Istogut
Drejtoria për Arsim dhe Kulturë
05.Nr.652/15
Datë: 24.11.2015



Në bazë të nenit 8 të Rregullorës Komunale për bursa, nr.5/2015, Drejtoria Komunale për Arsim dhe Kulturë, shpall:

K o n k u r s

Për ndarjen e 35(tridhjetë e pesë) bursave Komunale për studentë,
Të drejtë për aplikim kanë të gjithë studentët nga komuna e Istogut të cilët plotësojnë këto kushte:

- Të jenë studentë të rregullt, në njërën nga Fakultetet publike në Republikën e Kosovës,
- Të mos jenë shfrytëzues burse apo shfrytëzues të ndonjë burimi financiar nga marrëdhënja e punës,
- Të jenë studentë të rregullt që nuk e kanë humbur (përseritur) vitin e studimeve,
- Gjendja ekonomike sociale e dëshmuar me dokumentacion nga institucioni përkatës.

Dokumentacioni i nevojshëm:

- *Vërtetimi i semestrit për vitin akademik të studimeve 2015/2016, Certifikata e notave,
- *Vërtetimi që nuk shfrytëzon bursë universitare(vlen për studentët e vitit të dytë e tutje),
- *Çertifikata e gjendjes ekonomike,
- *Dëshmitë mbi gjendjen ekonomike e sociale nga Qendra për punë sociale,
- *Studentët me nevoja të veçanta fizike sjellin dëshminë nga Qendrat (organizatat) ku janë të evidentuar,
- *Studentet nga familja e ngushtë të dëshmorit, veteranit, invalidit, viktimave të luftës dhe studentët jetim, sjellin dëshminë nga organet gjegjëse,
- *Studentet që janë dy ose më shumë nga e njejta familje e ngushtë sjellin vërtetimet për secilin dhe i bashkëngjisin aplikacionit,
- *Kopja e letërnjoftimit,
- *Studentet e vitit të parë sjellin kopjet e diplomës dhe dëftesave nga shkolla e mesme e lartë.

Komisioni do të përzgjedh dhe shpall listën e përfituesve, në bazë të kriterëve për vlerësim sipas nenit 7 të Rregullorës nr.5/2015.

Aplikacionet(kërkesat) merren, plotësohen dhe dorëzohen në Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Kulturë. Afati i konkurrimit 30 ditë, nga dita e publikimit

Kërkesat e pa kompletuara me dokumentacion të nevojshëm, nuk do të shqyrtohen nga ana e komisionit. Ato që arrijnë pas afatit nuk do të pranohen.

Data e publikimit: 25.11.2015

Drejtoria Komunale e Arsimit

